



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLLOKOTIT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Božidar Dejanović, Kryetar

Adresa: rr. Bajës , Kllkot, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kllkotit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kllkotit, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kllkotit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 302,551€.
- A2 Komuna nuk kishte bërë shpalosje të saktë të të dhënave në PVF për grantet e përcaktuar të donatorëve, ndarjen fillestare dhe finale të buxhetit, numrin e stafit të angazhuar me MSHV, si dhe avancet.
- C1 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV janë nënvlerësuar për 521,476€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Kllokotit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Kllokotit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna gjatë vitit 2020 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 24,263€ në kategori ekonomike jo adekuate.
Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 8,360€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë paga dhe mëditje si dhe 15903€ ishin paguar nga investimet kapitale për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, goftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kllkotit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kllkotit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kllkotit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kllkotit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kllkotit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë

e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos regjistrimi i pasurisë

Gjetja

Sipas nenit 6, paragrafi 3 të Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare - "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria."

- Pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte nënvlerësuar për 302,551€⁵ pasi që 11 pagesa nuk ishin regjistruar në SIMFK, prej tyre 79,875€ janë pasuri të blera në vitin 2020 ndërsa 222,676€ janë pasuri të blera në vitin 2019; si dhe
- Pasuritë nën 1,000€ nuk janë regjistruar nga komuna sepse softueri e-pasuria nuk është në përdorim, përderisa për stoqe komuna nuk ka të dhëna.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Regjistri jo i plotë i pasurive mbi/nën 1,000€ si dhe mos regjistrimi i stoqeve, rezultoi me mangësi informatash për pasuritë dhe raportim jo të drejtë të tyre. Po ashtu, rrit rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit të tyre.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se funksionalizohet sistemi e-pasuria në mënyrë që pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet të regjistrohen me vlerën e tyre të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në shpalosjen e PVF

Gjetja

Rregullorja e MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, përcakton detyrimet e raportimit, mënyrën e raportimit dhe formën e raportimit të organizatave buxhetore. Sipas rregullores pas secilit nen duhet të prezantohen shënime shpjeguese.

Mangësit e identifikuar në shpalosjen e shënimeve në PVF janë si në vijim:

- Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit-hyrjet e parasë së gatshme- shënim 11 - nuk janë paraqitur grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 12,237€;
- Tek dalja e parasë së gatshme- buxheti final është paraqitur në vlerë 1,379,000€ ndërsa vlera e saktë është 1,490,140€;
- Tek neni 14.6 - Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit-

komuna nuk kishte shpalosur saktë shpalosjet lidhur me ndarjet fillestare dhe finale të buxhetit;

- Tek shënimet shpjeguese përveç shumave të paraqitura nuk janë shpalosur detajet lidhur me të dhënat e prezantuara për të gjitha kategoritë, siç kërkohet me rregullore;
- Tek neni 27 - raporti për numrin e të punësuarve me kontratë për shërbime të veçanta – komuna ka paraqitur se ka angazhur 18 zyrtarë me marrëveshje për shërbime të veçanta përderisa kishte të angazhuar 48 zyrtarë; dhe
- Tek neni 20- raportimin për avancet e pa arsyetuara/ pa mbyllura nuk është prezantuar avansi i pambyllur për petty cash me vlerë 1,000€ i dt.09.07.2020.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës nga ana e menaxhmentit të Komunës.

Ndikimi

Mos shpalosja e saktë e të dhënave në PVF ndikon në prezantimin jo të saktë të gjendjes financiare të organizatës dhe keqinformimin e përdoruesve të PVF-ve.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshmeve dhe menaxhim jo i duhur i tyre

Gjetja

Sipas nenit 16 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore - çdo OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Llogaria e arkëtueshme e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 521,474€, ky nënvlerësim ka të bëjë me mos prezantimin e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë në vlerë 511,474€ si dhe llogarive të arkëtueshme për taksën e mbeturinave në vlerë 10,000€.

Mëtutje, Llogaritë e arkëtueshme krahasuar me vitin e kaluar janë rritur për 31,612€ (apo në masën prej 5%), rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët përgjegjës nuk i kishin kushtuar kujdesin e mjaftueshëm sigurimit të të dhënave në kohën e përgatitjes së PFV.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar ndikojnë në shpalosjen jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në PFV. Po ashtu, informatat e pasakta ndikojnë edhe në vendimet e padrejta që mund ti ndërmerr komuna për ti menaxhuar këto

llogari.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara saktë dhe me kohë, dhe të bëhet prerja në fund të vitit në mënyrë që në kohën e përgatitjes së PVF-ve për vitin 2021 vlera e tyre të shpaloset saktë. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Komuna gjatë vitit 2020 kishte realizuar të hyra në vlerë 129,735€. Këto të hyra janë kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat administrative, veprimtaritë biznesore, qiraja etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror (gjobat nga policia) në vlerë prej 2,638€.

Çështja B1 - Mos verifikimi i pronave tatimore

Gjetja Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën të Paluajtshme kërkohet që komuna gjatë vitit të kryej verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme.

Komuna në dy vitet e fundit nuk kishte arritur të verifikoj asnjë pronë të paluajtshme të regjistruar në komunën e saj.

Sipas zyrtarëve komunal mos verifikimi i pronës kishte ndodhur në mungesë të stafit dhe të sigurimit të teknologjisë të re e cila nevojitet për përkrahje të sistemit të ri të tatimit në pronë si dhe për shkak të situatës pandemike.

Ndikimi Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllim të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës aktuale të tatueshme si dhe të ndikojë në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave pasi që mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 149,762€, prej tyre ishin shpenzuar 147,766€. Këto shpenzime ishin kryesisht për mirëmbajtjen dhe riparimi i automjeteve, shpenzime për derivate, shërbime kontraktuese, etj. Kemi testuar shtatë mostra për teste substanciale në vlerë 20,071€ si dhe shtatë mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedura ligjore

Gjetja

Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114 në nenin 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Në katër raste angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta (pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik) ishte bërë përmes procedurave të thjeshtësuara e jo nëpërmjet procedurave të prokurimit siç kërkohet me legjislacionin përkatës. Zyrtarët ishin angazhuar për menaxhimin e situatës pandemike.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitive për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore njëherësh rrit rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për detyra të caktuara.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta bëhet në përputhje me kërkesat ligjore duke aplikuar procedurën adekuate të prokurimit, për të siguruar se personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja A4 - Parregullsi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në shtatë⁶ raste faturat në vlerë 61,422€ së bashku me situacionin mbështetës ishin pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve dhe kërkesës për mallra dhe shërbime.

Po ashtu në pesë pagesa në vlerë 50,731€ raporti i pranimi dhe urdhërblerja nuk janë nënshkruar fare nga zyrtarët e autorizuar.

Shkak i kësaj ishte mos komunikimi në mes njësisë kërkuese, zyrtarit për pranimin e faturave dhe zyrtarëve të pranimi të punëve/mallrave.

Ndikimi Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë pranimi të mallit dhe kryerjes së pagesave mund të ndikojë në pranimin e mallrave që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara dhe pagesa potencialisht të parregullta.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,416,831€, ndërsa vlera e pasurive jo-kapitale dhe stoqeve nuk është prezantuar në PFV. Ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 438,295€.

Çështja C2 - Dobësitë në menaxhimin e pasurive

Gjetja

Sipas neni 4.1 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare - "Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare".

Po ashtu, sipas nenit 19 - Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare duhet të përgatit raportin për kryerjen e inventarizimit.

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Komuna ka përgatitur draft rregulloren e brendshme për administrimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores së Thesarit 02/2013, mirëpo nuk është dërguar në kuvendin komunal për aprovim për shkak të gjendjes pandemike;
- Komisioni për Inventarizim të pasurisë ishte formuar mirëpo nuk kishte përgatitur raport për punën e kryer, ndërsa Komisioni i Vlerësimit të Pasurisë nuk ishte formuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mungesa e rregulloreve të brendshme si dhe mos inventarizimi dhe mos vlerësimi i pasurisë rrit rrezikun që pasuritë të keqpërdoren, tjetërsohen ose humbasin, dhe vlera e pasurive të organizatës të paraqitur në PVF të mos jetë e saktë.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë se aprovohet rregullorja e brendshme, po ashtu kryetari duhet të sigurojë se komisionet përkatëse themelohen dhe raportet e dalura nga këto komisione përgatiten dhe harmonizohen me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve për vitin 2021.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 58,149€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B2 - Menaxhimi jo adekuat i faturave të papaguara dhe raportimi i detyrimeve

Gjetja

Sipas nenit 37, paragrafi 2 i rregullores Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, ZKF është përgjegjës që të krijoj mekanizma të cilat mundësojnë regjistrimin e faturave të pranuar dhe të përcjellë procedimin për pagesë të këtyre faturave. Ndërsa sipas nenit 24, paragrafi 1.3, të gjitha faturat duhet të protokollohen dhe të evidentohen në librin e faturave.

Po ashtu, sipas nenit 5 të rregullores nr.02/2013 MF për Raportimin e Detyrimeve të Papaguara të Organizatave Buxhet -të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara përmes raporteve mujore.

Ne kemi identifikuar që Komuna e Kllkotit nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimi të faturave, ngase faturat e pranuar nuk protokollohen dhe nuk evidentohen në librin e faturave. Faturat e pranuar nuk kishin të vendosur as datë të pranimi të tyre.

Po ashtu, Komuna nuk kishte raportuar rregullisht në Thesar mbi detyrimet e papaguara në baza mujore. Gjatë vitit 2020 nuk kishte raportuar në Thesar për muajt shkurt, mars dhe prill.

Këto parregullsi kanë ndodhur pasi që Komuna nuk ka vendosur mekanizma të cilët mundësojnë regjistrimin e faturave të pranuar dhe procedimin me kohë të tyre për pagesë.

Ndikimi

Mos protokollimi i faturave rrit rrezikun e humbjes ose dyfishimit të pagesës së të njëjtës faturë dhe mos paraqitjes së gjendjes aktual të detyrimeve të Komunës.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen në librin e protokolleve për të përmbushur kërkesën e ligjit për protokollimin e dokumenteve. Gjithashtu, kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që raportimi i detyrimeve ndaj Thesarit të bëhet në baza mujore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm pasi që nuk i plotëson kriteret për ta themeluar këtë njësi.

Çështja B3 - Moszbatimi i funksionit të auditimit të brendshëm

Gjetja

Rregullorja Nr.01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksionit të Auditimit të Brendshëm në Subjetin e Sektorit publik, nenet 4 dhe 5 përcaktojnë funksionin dhe mënyrën e themelimit të NJAB-së. Bazuar në nenin 5 “ Subjekti i sektorit publik i cili ka buxhet më pak se tre milionë euro (3.000.000€), funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtron përmes mënyrave tjera sipas nën paragrafëve 1.2, 1.3. dhe 1.4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje. (Themelimin e një njësie të përbashkët, apo marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të auditimit nga një subjekt i sektorit publik apo kontraktimit të një kompanie profesionale sipas kriterëve të vendosura, me miratimin/ aprovimin paraprak të MF).

Komuna gjatë vitit 2020 nuk kishte arritur të sigurojë shërbime të auditimit të brendshëm përkundër faktit që një rekomandim i tillë ishte dhënë edhe në vitin 2019 nga ZKA. Komuna kishte bërë kërkesë për përfshirjen e saj në planin e auditimit të Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm (NJQHAB) me datë 12.11.2019.

Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur për shkak të pritjes së përgjigjes nga Ministria e Financave – NJQHAB për të kryer Auditim të brendshëm.

Ndikimi

Mungesa e auditimit të brendshëm rrit rrezikun që kontrollet e brendshme të mos jenë funksionale dhe njëherësh menaxhmenti në mungesë të informatave nuk mund të ndërmarrë veprimet e nevojshme për eliminimin e mangësive të tilla.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që aktivitetet e komunës i nënshtrohen auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,137,495.00	1,490,140	1,356,585.00	1,289,491	1,327,317
Grante Qeveritare – Buxheti	978,653.00	1,273,925	1,263,536	1,137,347	1,051,964
Financimi përmes huamarrjes	0.00	5,040.00	5,040.00	0.00	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	40,095.	38,057	21,356	150,800
Të hyrat vetanake	158,842.00	158,842.00	38,057	130,788	124,553
Donacionet e jashtme	0.00	12,238	11,895.00	0.00	0.00

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 352,645€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, donacioneve si dhe financimit nga huamarrja.

Në vitin 2020, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 1,356,585€, me një ulje prej 8% krahasuar me vitin 2019. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,137,495.00	1,490,140	1,356,585.00	1,289,491	1,327,317
Pagat dhe mëditjet	760,000.00	802,140	801,698	775,622	702,655
Mallrat dhe shërbimet	120,000.00	149,762	147,766	125,695	131,746
Komunalitë	45,000.00	45,000.00	24,538	45,261.00	25,745
Subvencionet dhe transferet	6,644.00	278,825	278,445	12,642.00	8,764
Investimet Kapitale	165,851.00	214,413	104,138	330,271	458,407
Rezervat	40,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 42,140€ si rezultat i financimit përmes huamarrjes, si dhe me rishikim të buxhetit, ky buxhet ishte shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 29,762€, si rezultat i shpërndarjes të të hyrave vetanake, donacioneve, si dhe sipas vendimit të Qeverisë Nr.01/23 të dt. 13.08.2020;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 272,182€, si rezultat i shpërndarjes të të hyrave vetanake, si dhe sipas vendimit të Qeverisë Nr.01/23 të dt. 13.08.2020;
- Buxheti final për shpenzimet kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 48,562€, si rezultat i shpërndarjes të të hyrave vetanake, si dhe donacioneve;

Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 277,585€, prej tyre 14,805€ ishin për shtesa në paga, 980€ mallra dhe shërbime si dhe 261,800€ subvencione dhe transfere.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Vlera e të hyrave të arkëtuara gjatë vitit 2020, ishte më e ultë për 33,381€ në krahasim me vitin paraprak, që rezulton me 20% realizim më të dobët.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	158,842.00	158,842.00	129,735	163,116	133,635
Të hyrat tatimore	85,165.00	85,165.00	22,671	83,989	65,414
Të hyrat jo tatimore	73,677.00	73,677.00	107,064	79,127	68,221

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2019 për komunën ka rezultuar me 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, dy ishin në proces, tri rekomandime nuk janë adresuar ende dhe një rekomandim nuk është i zbatueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ndarjes adekuate të buxhetit. Nëse projeksionet e buxhetuara me ligj të buxhetit nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe kërkesat e komunës, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve. Kjo duhet të reflektoj në përpjekjen për buxhetimin e kërkesave në kategoritë përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për pagesën, evidentimin dhe prezantimin e drejt të shpenzimeve publike në PFV.	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që është realizuar planifikimi objektiv për mbledhjen e të hyrave vetjake bazuar në	Nuk kemi identifikuar çështje të	I zbatuar


		një analizë të mirëfilltë paraprake	ngjashme.	
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të iniciojë ri-miratimin e Rregullores për pagesën e shërbimeve në mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave, në përputhje me Ligjin Nr. 04 / L-060 për mbeturinat.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të analizojë arsyet dhe pengesat për shkak të të cilave nuk janë zbatuar kërkesat ligjore në këtë fushë dhe të ndërmarrë veprime shtesë me qëllim të verifikimit të pronës komunale në vitin e ardhshëm në përputhje me ligjin.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Pagat dhe mëditjet	Komuna duhet të urdhërojë ndryshime në koeficientet dhe kontratat për të gjithë punonjësit e departamentit të arsimit në përputhje me normën.	Gjatë periudhës së auditimit është rregulluar.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për vende pune të rregullta dhe afatgjate, adresohen në MF përmes planifikimit adekuat të buxhetit, duke siguruar që angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme. Legjislacioni ka pësuar ndryshime në mes të vitit dhe është trajtuar me legjislacionin e ri.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që forcohen kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, duhet të sigurohet që marrëveshjet për bashkëfinansim me ministritë të sqarojnë pronësinë e objekteve të ndërtuara pas përfundimit. Gjithashtu është e nevojshme të rritet bashkëpunimi i Zyrtarit të Pronës me Thesarin në mënyrë që të mundësohet regjistrimi i investimeve të reja në objektet ekzistuese, si dhe vlera e shtuar e objektit bazë.	Komuna ka përgatitur draft rregulloren e brendshme, si dhe ka caktuar komisionin për inventarizim, ndërsa sa i përket regjistrimit të pasurisë ende nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Kryetari duhet të sigurojë që avancet të justifikohen brenda një periudhe të caktuar me Rregulloren 2004/07. Formularëve të mbylljes duhet t'i bashkëngjiten të gjitha faturat, kërkesat dhe listat para momentit të mbylljes.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
9.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të analizojë arsyet e trendit në rritje të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë dhe të forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Kryetari duhet të krijojë një strategji dhe mekanizma për të mundësuar identifikimin dhe mbledhjen e borxheve të akumuluar, përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në dëshmitë për	Gjatë vitit 2020 për shkak të gjendjes së pandemisë COVID-19 komuna nuk ka arritur të rris nivelin e inkasimit të hyrave nga tatimi	Pjesërisht i zbatuar

		pagesën e tatimin në pronë. Gjithashtu, është e nevojshme që Komuna të menaxhojë në mënyrë të duhur llogaritë e arkëtueshme për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave	në pronë.	
10.	Obligimet papaguara	e Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të siguruar që prezantimi i detyrimeve dhe detyrimeve kontigjente të jetë i saktë.	Gjatë testimeve tona kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
11.	Obligimet papaguara	e Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen në librin e protokolleve për të përmbushur kërkesën e ligjit për protokollimin e dokumenteve. Gjithashtu, kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që raportimi i detyrimeve ndaj Thesarit të bëhet në baza mujore.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje.	Nuk ka filluar zbatim
12.	Auditimi Brendshëm	i Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Rregullores së Brendshme Nr. 01/2019 dhe të sigurojë zbatimin e funksionit të kontrollit të brendshëm përmes një prej mënyrave të parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, sepse funksioni i auditimit të brendshëm shton vlerë në menaxhimin përgjegjës duke siguruar sigurime këshilluese të orientuara drejt rrezikut.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje.	Nuk ka filluar zbatim

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna. Po ashtu, kryetari duhet të sigurojë se funksionalizohet sistemi e-pasuria në mënyrë që pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet të regjistrohen me vlerën e tyre të saktë.
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të ndërmerr masa për të siguruar se llogaritë e arkëtueshme janë të evidentuara saktë dhe me kohë, dhe të bëhet prerja në fund të vitit në mënyrë që në kohën e përgatitjes së PVF-ve për vitin 2021 vlera e tyre të shpaloset saktë. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha masat ligjore për arkëtimin e LL/A tjera nga të gjithë pronarët e pronave.
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave pasi që mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.
5.	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i zyrtarëve me marrëveshje për shërbime të veçanta bëhet në përputhje me kërkesat ligjore duke aplikuar procedurën adekuate të prokurimit, për të siguruar se personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara.
6.	Çështjet përbashkëta	e Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se aprovohet rregullorja e brendshme, po ashtu kryetari

		duhet të sigurojë se komisionet përkatëse themelohen dhe raportet e dalura nga këto komisione përgatiten dhe harmonizohen me regjistrat e pasurisë para përgatitjes së PFV-ve për vitin 2021.
8.	Obligimet papaguara	e Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të regjistrohen në librin e protokolleve për të përmbushur kërkesën e ligjit për protokollimin e dokumenteve. Gjithashtu, kryetari duhet të forcojë kontrollin e brendshme në mënyrë që raportimi i detyrimeve ndaj Thesarit të bëhet në baza mujore.
9.	Auditimi Brendshëm	i Kryetari duhet të sigurojë që aktivitetet e komunës i nënshtrohen auditimit të brendshëm, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të Komunës, që ndihmon në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm




Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Udhëheqës i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Sylaj, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Klokot / Opština Klokot / Municipality of Klokot

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjetë Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për
zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Klllokotit , për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Z. Bozidar Dejanovic
Kryetar i Komunes se Klllokotit
Data: 22.Korrik.2021, Klllokot.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Ndërtimi i ambulancës në Mogila është e gjetur në raport të auditimit 2019, kjo pasuri nuk është regjistruar në regjistra as gjatë vitit 2020, si dhe komuna nuk na ka ofruar dëshmi për vlerën e saj.
- ⁶ Ndërtimi i rrugëve lokale me vlerë 9,335€, Asfaltimi i rrugëve lokale me vlerë 13,436€, Mbushja e rrugëve fushore me vlerë 7,015€, Asfaltimi i rrugëve me vlerë 11,895€, Rregullimi i shtratit të lumit me vlerë 15,285€, Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve me vlerë 1,356€ dhe Shërbime tjera kontraktuese me vlerë 3,100€.
- ⁷ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.